

## PËLLUMB XHUFI

### NDIKIME ITALIANE NË RILINDJEN KOMBËTARE SHQIPTARE

Në fund të shek. XVIII, në një nga letrat e tij të fundit nga Shqipëria, konsulli i Republikës së Venedikut në Durrës, A. Morana, i ngre hymne një atdheu të ri, Italisë (*la nostra bella Italia*)<sup>1</sup>, ndërsa deri atëherë i kishte qëndruar besnik vendlindjes së tij, Republikës së vogël dhe aristokrate të Shën Markut. Sigurisht, me këtë kapërcim nga “atdheu i vogël”, në “atdheun e madh”, Morana mund të konsiderohet një ndër pararendësit e lëvizjes për çlirim e bashkim të Italisë. Sigurisht, nuk qe as i pari dhe as i vetmi. Por bën përshtypje që kjo deklaratë dashurie për Italinë e madhe dhe të përbashkët, vjen pikërisht nga Shqipëria, një vend që prej tre shekujsh ndodhej nën zgjedhën otomane, duke lënguar në kushtet e një prapambetjeje të frikshme ekonomike, sociale e kulturore.

E megjithatë, edhe në Shqipëri po ndjehej aso kohe ndërrimi i epokave. Pikërisht në kapërcimin e shekujve XVIII-XIX, raportet e konsujve venecianë dhe të atyre francezë nga Durrësi dhe nga portet e tjera të Adriatikut, zbulojnë se një klasë e re, bartëse e ideve të reja kishte lindur edhe në Shqipëri. Fjala ishte për tregtarë, mësues, mjekë, funksionarë, dragomanë, të cilët ishin të parët që binin në kontakt me konsujt apo udhëtarët e huaj dhe që frekuentonin rregullisht selitë konsullore në fjalë, ose tregjet e Venedikut e të Evropës Qendrore. Pikërisht, midis kësaj kategorie njerëzish të mësuar e të shëtitur shquhen edhe ithtarët e parë të ideve të Iluminizmit e të Revolucionit Francez. “Thuajse të gjithë tregtarët e Janinës e të Shqipërisë”, thotë një burim francez i vitit 1793, “janë sans-culottes, që kanë përkthyer Deklaratën e të Drejtave të Njeriut, të cilën e dinë për mendësh”<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Giovanni Antonio Maria Morana, *Saggio delli commerciali rapporti dei Veneziani colle ottomane scale di Durazzo et Albania e con quelle di Aleppo, Siria e Palestina*, Venezia: 1816, p. 35.

<sup>2</sup> *Documente privitoare la Storia Românilor urmare la colecțiunea lui R. De Hurmuzaki*, Suplement I. Volumul 2 (1781-1814). Documente culese din Archivele Ministeriului Afacerilor Straine din Paris de A. I. Odobescu, Bucuresci: 1885, f. 94.

Në fakt, rrënjët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, konkludon prof. R. Qosja, qëndrojnë sa në të kaluarën historike e kulturore të popullit shqiptar, aq edhe në ndikimet e Iluminizmit, të Revolucionit Francez dhe të *Risorgimento*-s italiane. Skënderbeu dhe Garibaldi ishin heronjtë e saj, ndërkohë që Rousseau, Voltaire, Hugo, Lamartine dhe Manzoni përfaqësojnë panteonin e saj letrar<sup>3</sup>.

Sigurisht, ishin para së gjithash kontaktet me Venedikun, të cilat vazhduan edhe gjatë shekujve të sundimit otoman, ato që ndihmuan depërtimin e ideve të Iluminizmit<sup>4</sup>. Nëse Franca ishte, gjithsesi, tepër larg, Italia ishte aty afër dhe, për rrjedhojë, lëvizjet dhe revolucionet e saj gjetën pasuesit e tyre edhe në tokën shqiptare. Njëri ndër ta, Pashko Vasa, një përfaqësues i shquar i elitës së re shqiptare, duke qenë se mungonin kushtet e duhura në Shqipëri, mendoi ta shprehë vullnetin e tij për ndryshim duke marrë pjesë në Revolucionin e Venecias, në vitin 1848. Ndonjë vit më vonë, në një italishte të përkryer, vetë Vaso Pasha do ta shpjegonte me këto fjalë atë përvojë të parë revolucionare: “Dashuria për Italinë dhe për drejtësinë ishin ato që më shtynë të braktis atdheun tim e të marr pjesë në atë luftë për mbrojtjen e lavdishme të Venedikut”<sup>5</sup>.

Lëvizja për Rilindje Kombëtare synonte para së gjithash ta nxirrte Shqipërinë nga një sundim cfilitës, që nuk po donte të merrte fund. Por, nga ana tjetër, ajo lindi si një domosdoshmëri për t’iu kundërvënë synimeve të monarkive të reja fqinje të Greqisë, Serbisë e Malit të Zi, të cilat u lëshuan të aneksojnë territore shqiptare, ende pa dhënë shpirt Perandoria Osmane. Pra, duhej kërkuar krijimi i shtetit kombëtar shqiptar, por akoma më përpara, duheshin njohur të drejtat kombëtare të shqiptarëve, duke përmbysur një raport të dëmshëm e të rrezikshëm inferioriteti kundrejt kombeve të tjera të Ballkanit, të cilët kishin qenë më me fat edhe për shkak se gëzonin mbështetjen dhe mbrojtjen e një Evrope të ngarkuar me paragjykime për “myslimanët” shqiptarë<sup>6</sup>.

<sup>3</sup> Rexhep Qosja, *La question albanaise*, Paris: “Fayard”, 1995, f. 17.

<sup>4</sup> Do të mjaftonte të sillej si provë e këtyre lidhjeve, masa e madhe e dokumentacionit venecian, që i përket fondeve të konsullatës veneciane të Durrësit, nënkonsullatës së Shkodrës, si dhe fondi i jashtëzakonshëm i bajlive venecianë të Korfuzit, të cilin jemi duke e përgatitur për botim.

<sup>5</sup> Pashko Vasa, *La mia prigionia. Episodio storico dell’assedio di Venezia*, Constantinopoli: 1850.

<sup>6</sup> Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët. Studim historik, Përkthim dhe komentim prej Mehdi Frashërit*, Tiranë: 1935 (sipas botimit francez,

Kjo dëshirë për t'u matur denjësisht me fqinjët, karakteristikë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i dha jetë një forme patologjike të ndërgjegjes kombëtare, e cila ngrinte lart virtytet dhe epërsinë e racës shqiptare. Nuk është një rastësi, që thujse të gjithë aktivistët e Rilindjes e bënë të tyren “tezën pellazgjike”, që i konsideronte shqiptarët si pasardhës të drejtpërdrejtë të popullit parahistorik të pellazgëve<sup>7</sup>. Përkrahësit e parë të saj ishin disa personalite të dalluara të Arbëreshëve të Italisë, si Giuseppe Schirò (1831)<sup>8</sup>, Girolamo de Rada (1840)<sup>9</sup> e Vincenzo Dorsa (1847)<sup>10</sup>, të cilët në Shqipëri u pasuan nga Pashko Vasa (1879)<sup>11</sup>, Sami Frashëri (1899)<sup>12</sup> e shumë të tjerë. Teza e prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve mori një njohje të rëndësishme ndërkombëtare, nga momenti kur emra të dëgjuar të shkencës evropiane, si albanologu Georg von Hahn, zbritën në fushë për ta mbrojtur atë<sup>13</sup>.

Kështu pra, duke “përvetësuar” trashëgiminë pellazgjike, shqiptarët rezultojnë të ishin populli më i lashtë i Ballkanit, shumë më i lashtë se sllavët dhe se vetë grekët, që mbaheshin si armiqtë e tyre më të rrezikshëm. Duke u nisur nga një siguri e tillë pellazgjike, në vitin 1897, Jeronim de Rada i lëshohej “grekëve dinakë”, të cilët thurrnin komplete kundër mëmëdheut shqiptar<sup>14</sup>. Në vitin 1899, Nikolla Naço u shtyq përpara në arsyetimet e tij patriotike, saqë guxoi të pretendojë që edhe Roma kishte qenë themeluar nga shqiptarët, “zbulim” që ia tregoi të parit,

---

Paris: 1879), f. 101; Nikolla Ivanay Bey, *Conferenza tenuta in Roma all'Associazione della Stampa Italiana*, 26 gennaio 1911, Roma: Comitato Italiano “Pro Albania”, 1912, f. 15.

<sup>7</sup> Demetrios A. Stamatopoulos, *To Byzantio metà to ethnos. To problema tes synecheias stis balkanikes istoriographies*, Athena: Alexandria ekd., 2009, f. 313-323.

<sup>8</sup> Jup Kastrati, *Historia e Albanologjisë, 1497-1997*, Tiranë: “Argeta LMG”, 2000, f. 571-575.

<sup>9</sup> Girolamo De Rada, “Identità degli Albanesi co'Pelasgi”, in: E. Bidera, *Quaranta secoli: racconti su le Due Sicilie*, Napoli: 1946.

<sup>10</sup> Vincenzo Dorsa, *Su gli Albanesi. Ricerche e pensieri*, Napoli: 1847.

<sup>11</sup> V. Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët ...*, f. 77-81.

<sup>12</sup> Sami Frashëri, “Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë”, në: *Vepra*, vëll. 2, Prishtinë: “Rilindja”, 1978, f. 313-323.

<sup>13</sup> Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena: 1854, f. 214-229.

<sup>14</sup> *La Nazione Albanese*, nr. 5, Catanzaro, 15 marzo 1897.

as më shumë e as më pak, se Ricciotti Garibaldit!<sup>15</sup> Përpjekjet e ethshme për të afirmuar veten në dëm të atyre fqinjëve, që mohonin ekzistencën e kombit shqiptar, ndonjëherë ngjitej deri në kufijtë e racizmit. Qysh në vitet 1770 një prift arbëresh, at Giorgio Guzzetta shkroi një traktat të shkurtër, ku pasi provonte se shqiptarët, përfshirë edhe ata të besimit ortodoks, ishin një popull i ndryshëm nga grekët “për nga gjuha, për nga dashuria për jetën e për sjelljet njerëzore”, e ndjente me vend të fliste edhe për “urrejtjen e madhe dhe antipatinë natyrore që shqiptarët ushqenin kundrejt grekëve”. Arsyet, sipas tij, ishin të natyrës racore: shqiptarët kishin zemër, kishin burrëri, ishin ushtarë të lindur; kurse grekët ishin “njerëz të fryrë dhe me zemër prej femre”. Ishte një lloj hakmarrje e një prifti të thjeshtë arbëresh ndaj atyre grekëve, që nga ana e tyre, “i quanin shqiptarët si të pagdhëndur e injorantë”<sup>16</sup>. Nikolla Naço, një shqiptar nga Shqipëria, shpreh gjithashtu ndjenja të ngjashme urrejtjeje dhe hakmarrjeje, kur pretendon t’u atribuojë grekëve një origjinë egjiptiane ose fenikase<sup>17</sup>. Të gozhduar në llogoret e një refuzimi total ndaj çdo perspektive marrëdhëniesh me grekët, ai dhe veprimtarët e tjerë të Lëvizjes Kombëtare parapëlqyen të injorojnë deri edhe tezën “e leverdisshme” mbi të ashtuquajturin “shqiptarizim” të Greqisë në Mesjetën e vonë, me të cilën historiani gjerman Fallmerayer, armiku numër një i nacionalizmit grek, vazhdon të trazojë ndërgjegjen kombëtare helene.<sup>18</sup>

Gjithsesi, nëse ky moment i parë i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që kishte të bënte me raportet me historinë dhe me fqinjët, u karakterizua nga jo pak virulencë nacionaliste, momenti që ndoqi pas ishte shumë më tepër reflektiv e i paqëm. Përtej lavdive të së shkuarës dhe përtej virtyteve natyrore të shqiptarëve, patriotët shqiptarë ishin fort të vetëdijshëm për gjendjen e vazhdueshme në të cilën vazhdonte të dergjej

<sup>15</sup> Francesco Guida, “Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese”, në: *Archivio Storico Italiano*, anno CXXXIX, disp. 1, Firenze 1981, f. 112.

<sup>16</sup> P. Giorgio Guzzetta, *L’osservanza del rito presso gli Albanesi d’Italia perchè giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*, a cura di M. Mandalà, Quaderni di Biblos, Palermo: 2007.

<sup>17</sup> F. Guida, “Ricciotti Garibaldi ed il movimento ...”, f. 112.

<sup>18</sup> Giorgos Veloudis, “Jakob Philipp Fallmerayer und die Entstehung des neugriechischen Historismus”, në: *Südost-Forschung*, 29 (1970), f. 43-90; Gustav Auernheimer, “Fallmerayer, Huntigton und die Diskussion um die neugriechische Identität”, në: *Südost-Europa*, 47. Jahrgang: 1998, f. 1-17.

populli i tyre qysh nga vdekja e Skënderbeut, më 1468. Sipas Pashko Vasës (1879), sundimi i gjatë osman i kishte bërë bashkëpatriotët e tij “të shastisur, të qulltë, mosbesues, të dëshpëruar, injorantë”<sup>19</sup>. Ndaj, pas shekujve të tërë “gjumi” duhej rilindur, dhe kjo rilindje shqiptare, nën shembullin e Rilindjes (Risorgimento) Italiane, metaforikisht kuptohej si një rikthim në fuqinë, në burrërinë e në dinjitetin e dikurshëm<sup>20</sup>.

Por, më së pari duhej kultivuar ndërgjegjja kombëtare. Dhe për të bërë këtë, duhej filluar nga shkolla, një shkollë kombëtare të mohuar deri atëherë nga Porta e Lartë dhe Patrikana Greke e Stambollit, të bashkuara në refuzimin me çdo kusht të kombësisë shqiptare. Aty, mbi bazën e një alfabeti dhe të një *koiné*-je të pranuar nga të gjithë, duhet të niste rruga e gjatë dhe e ndërlikuar e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Mësimi i gjuhës, i historisë dhe i kulturës shqipe u ndje si një domosdoshmëri nga të gjithë patriotët shqiptarë, nga Sami Frashëri, Jeronim de Rada, Asdreni, Shahin Kolonja, Luigj Gurakuqi, Visarion Dodani e Aleksandër Xhuvani<sup>21</sup>. Përfaqësuesit më të shquar të Rilindjes Shqiptare, që ishin njerëz me kulturë të gjerë, e vunë veten në rolin e mësuesit të thjeshtë dhe të autorit të teksteve shkollore të nivelit të ulët. Shumë prej tyre, duke ndeshur në ndalimin e rreptë të Portës, kuturisën të botonin jashtë Shqipërisë libra e gazeta në shqip, që mandej përhapeshin fshehurazi në vend<sup>22</sup>.

Programi politik i Lëvizjes Kombëtare parashikonte krijimin e një Shqipërie, një e të pandarë, që duhej të bashkonte në një shtet të pavarur e të njësuar të gjitha territoret shqiptare. Vetë njësimi i gjuhës shqipe, në pluralitetin e alfabeleve dhe të dialekteve, duhej t’i shërbente arritjes së këtij qëllimi. Sigurisht, diviza “Shqipëria një dhe e pandarë” ngjan një

<sup>19</sup> P. Vasa, *E vërteta mbi Shqipërinë*..., f. 102.

<sup>20</sup> Silvana Patriarca, “Indolence and regeneration: tropes and tensions of Risorgimento patriotism”, në: *The American Historical Review*, vol. 110, nr. 2, April 2005, f. 380-408.

<sup>21</sup> *Mendimi Politik e Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Përmbledhje artikujsh nga shtypi*, vol. I (1879-1908), përgatiti për botim Zihni Haskaj, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1971, f. 227-303; Letër e Sami Frashërit për Jeronim de Radën, 21 febrario 1881, në: *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Tiranë, Fondi: Sami Frashëri, dosja 4, nr. 904524.

<sup>22</sup> George W. Gawrych, *The Crescent and the Eagle*, London: I. B. Tauris & Co Ltd, 2006 (bot. Tiranë: 2007), f. 137.

përsëritje e formulës “Italia një dhe e pandarë” e Risorgimento-s Italiane. Por nuk është pa kuptim fakti, që kjo formulë në Itali pati për autor Francesco Crispin<sup>23</sup>, apo, sipas disave, Pasquale Scuran, ministër i Drejtësisë i Direktoratit të Garibaldit<sup>24</sup>. Që të dy këta ishin arbëreshë nga Siçilia. Dhe nuk ishte një rastësi që, siç vëren me të drejtë A. Biagini, Lëvizja Kombëtare Shqiptare u ndihmua edhe nga mbështetja dhe nga përvoja e arbëreshëve të Italisë, të cilët kishin marrë pjesë me përkushtim në Risorgimenton dhe në themelimin e shtetit të bashkuar italian<sup>25</sup>. Se sa intensive ishin kontaktet mes personaliteteve arbëreshe dhe eksponentëve më të lartë të Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri apo në kolonitë, në Stamboll, Sofje, Bukuresht, Kajro e SHBA, këtë e provon botimi i gazetave, si “Flamuri i Arbërit”, “La Nazione Albanese”, që drejtoheshin nga arbëreshët Jeronim de Rada e Anselmo Lorecchio; e provon, gjithashtu, krijimi i komiteteve “Pro-Albania”, si dhe nismat e shumta të ndërmarra në Itali në favor të çështjes shqiptare, siç ishin kongreset ndërkombëtare mbi gjuhën shqipe, të mbledhura në Itali në vitet 1895 e 1897.

Në këtë pikë, lind nevoja të flasim mbi ndikimin e fuqishëm, të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet arbëreshëve, që Risorgimentua italiane ushtroi mbi ideologët e Rilindjes Shqiptare. Por duhet thënë qysh në fillim, se bëhej fjalë për dy situata e dy skenarë të ndryshëm, që impononin gjithashtu zgjedhje po aq të ndryshme. Modeli i regjimit, që patriotët shqiptarë synonin të vendosnin pas çlirimit nga zgjedha osmane, ishte pikërisht ai i përvijuar nga Rousseau: një regjim republikan, i bazuar mbi sovranitetin e popullit e mbi barazinë shoqërore e politike të të gjithë qytetarëve<sup>26</sup>. Sa për mjetet e rrugët për të mbërritur në këtë objektiv, aktivistët e Lëvizjes Kombëtare iu drejtuan shpesh Giuseppe Mazzinit dhe idesë së tij për “revolucionin nga poshtë”, i cili ishte në gjendje për të garantuar bashkimin, si një proces politik gjithëpërfshirës dhe i gjithëpranuar, dhe jo si një aneksim i një krahine nga një tjetër. Për njerin prej tyre, Nikollë Ivanajn, një mazzinian i betuar, do të flasim më

<sup>23</sup> Thomas Palamenghi-Crispi, *The Memoires of Francesco Crispi*, vol. I, Hodder and Stoughton, New York-London: 1912, f. 464.

<sup>24</sup> Mario Brunetti, *Il Risorgimento una rivoluzione conservatrice*, Collana dell'Istituto Mezzogiorno-Mediterraneo, Cosenza: 2012, f. 36.

<sup>25</sup> Antonello Biagini, *Storia dell'Albania*, Milano: “Bompiani”, 1998, f. 76.

<sup>26</sup> André Soboul, *Die grosse französische Revolution. Ein Abriss ihrer Geschichte (1789-1799)*, Frankfurt am Main, Athenäum, 1988, f. 47-50.

poshtë. Gjithsesi, patriotët shqiptarë përfshinë në luftën e tyre për bashkimin e vendit edhe elementë të problematikës shoqërore, gjë që i mungoi Risorgimentos Italiane. Dihet se në Itali, qoftë Cavour e Manin, e qoftë Mazzini, evituan t'i japin lëvizjes së tyre ndonjë përmbajtje klasore<sup>27</sup>. Ata nuk parashikonin asnjë lloj përmbysjeje shoqërore: “Nuk e duam terrorin të ngritur në sistem, nuk e duam abrogimin e të drejtave të fituara me ligj, nuk duam një ligj agrar, as edhe dhunimin e pasurive personale dhe sekuestrimin e pronave...Nëse një revolucion do ta shndërroni në një luftë klasash, ose do të dështoni, ose do të mbijetoni falë krimeve të padëgjua, falë etjes prej uzurpatori dhe falë vendosjes së një tiranie të re”<sup>28</sup>.

Ndryshe nga Risorgimento Italiane, Rilindja Kombëtare Shqiptare nuk mund të mos i merrte në konsideratë dallimet dhe kundërvëniet shoqërore, që ishin krijuar gjatë më shumë se katër shekujve të sundimit osman. Shqiptarët ndodheshin në një gjendje të pashpresë, ishin të ndarë dhe të zhveshur nga çdo e drejtë elementare kombëtare dhe përgjegjësia për këtë gjendje binte sa mbi regjimin osman, aq edhe mbi aristokracinë e vjetër feudale shqiptare, e cila ishte bërë pjesë përbërëse e sistemit të shtypjes e të shfrytëzimit të popullit të vet. Deri në Shpalljen e Pavarësisë, më 1912, ishin të shumtë pronarët e mëdhenj të tokave, të cilët vazhduan të ndjeheshin si pjesë e aristokracisë dhe e burokracisë osmane, duke iu kundërvënë çdo lëvizjeje që synonte emancipimin e kombit shqiptar. Në ato momente vendimtare, deri edhe një prej përfaqësuesve më të edukuar e më të ndriçuar të bejlerëve shqiptarë, Eqrem Bej Vlora, u shqua si mbrojtës i vendosur i regjimit të vjetër<sup>29</sup>.

Në këto kushte, boshti kryesor i Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri, si kudo në Evropë<sup>30</sup>, u bë klasa e mesme, e përfaqësuar nga intelektualët, tregtarët, botuesit e gazetave dhe nëpunësit, të cilët u mblodhën të gjithë

<sup>27</sup> Giuliano Procacci, *Storia degli Italiani*, Tiranë: “Toena”, 2000, f. 357.

<sup>28</sup> Stuart J. Woolf, *Storia d'Italia, III: Dal Primo Settecento all'Unità*, Einaudi, Torino: 1973, f. 314; Giuseppe Mazzini, *Scritti editi ed inediti, Imola 1906-1940*, vol. II, f. 193, 195.

<sup>29</sup> Franklin Xega, “Çështja e alfabetit dhe mitingu i shkronjave në Korçë”, në: *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: 1972, f. 135-141; Ilo Mitkë Qafëzezi, *Dhaskal Gjoka*, Korçë: 1936, f. 154; *Dielli*, Boston, 4 mars 1910.

<sup>30</sup> Furio Diaz, *Dal movimento dei lumi al movimento dei popoli: l'Europa tra illuminismo e rivoluzione*, Bologna: “Il Mulino”, 1986, f. 174.

si vëllezër, pavarësisht nëse ishin të pasur apo të varfër, të krishterë apo myslimanë, gegë të Veriut, apo toskë të Jugut<sup>31</sup>.

Një provë të armiqësive që ekzistonin midis përfaqësuesve të grupimit revolucionar dhe eksponentëve të aristokracisë së vjetër, vegla të bindura të osmanëve, e gjejmë në artikullin “Dy fjalë për bejlerët tanë”, botuar më 12 shtator 1901 në gazetën “Albania”, që dilte në Romë. Autori, Dervish Hima, i stigmatizonte pronarët e mëdhenj se ishin “tradhëtarë të çështjes shqiptare”, dhe u kujtonte se në Evropë, mbi njerëz si ata, “kishte rënë drejtësia e popullit, pasi aty mbretërit dhe fisnikët kishin kaluar në tehun e shpatës”<sup>32</sup>. Gjuha prej Robespieri ishte tepër e ashpër e kërcënuese, dhe qeveria italiane e mbylli gazetën dhe e dëboi Himën nga Italia.

Por u shënuan edhe raste, kur përfaqësues të klasës së vjetër të bejlerëve e të funksionarëve të lartë të Perandorisë Osmane, tashmë të bindur për fundin e pashmangshëm të asaj Perandorie, iu bashkuan lëvizjes, gjë që solli mpirjen e nervit revolucionar dhe devijimin e saj drejt brigjeve më të qeta të marrëveshjeve politike e diplomatike. Ishte mënyra e vetme për të siguruar një rol në Shqipërinë e re, që siç po dukej, do i përkiste asaj klase të mesme, aq shumë të urreyer nga Eqrem Bej Vlora dhe nga sëra e tij<sup>33</sup>. Në fakt, shumë syresh arritën të depërtojnë në klasën e re politike që udhëhoqi betejat për pavarësinë dhe ngritjen e shtetit të ri shqiptar, duke e molepsur atë me reflekset e veta të pavendosmërisë, të ujdive të paprincipita e të tradhtisë, që aq shumë i kujtuan vendit<sup>34</sup>.

<sup>31</sup> “Memorandum i Komitetit Shqiptar të Stambollit”, shkruar nga Pashko Vasa e dorëzuar ambasadorit të Austro-Hungarisë, më 22 tetor 1878, teksti në: *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1978, f. 68; “La Lega Albanese”, kryeartikull i gazetës *La Riforma*, Romë, 9 tetor 1878.

<sup>32</sup> Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)*, Tiranë, “8 Nëntori”, 1987, f. 97.

<sup>33</sup> Ekrem Bey Vlora, *Lebenserinnerungen*, Band. I: 1885-1912, München: Oldenbourg, 1968, f. 3-5; Band. II: 1912-1925, München: 1973, f. 20, 57, 66, 140, 182, 183, 220.

<sup>34</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 479; Zekeria Cana, “Rivrojtime të Kryengritjes së Madhe të vitit 1912”, në: *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, Instituti i Historisë, Tiranë: “Klean”, 2008, f. 59, 63.

U prek më sipër roli i arbëreshëve të Italisë. Njëlloj si “Greqia e Madhe” në kohët antike, në Itali u krijua, duke filluar nga shek. XV, një “Shqipëri e vogël”, e përfaqësuar nga ngulime të dendura shqiptarësh, që kishin braktisur vendin e tyre pas vdekjes së Skënderbeut. Pikërisht, tek këta shqiptarë u shfaqën shenjat e para të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kjo ishte, para së gjithash, një lëvizje kulturore, që kishte për qëllim parësor t’u mësonte fëmijëve dhe gjithë popullit të lexonin e të shkruanin në gjuhën shqipe, të njihnin historinë e kulturën e kombit të tyre. Të njëjtën domosdoshmëri e kishte shtruar me forcë edhe Risorgimenti italian. Si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, edukimi i popullit konsiderohej mjeti i vetëm efektiv për të “rilindur” kombin<sup>35</sup>. Është vërtet mbresëlënëse të konstantosh, se si midis veprimtarëve shqiptarë të Rilindjes, atyre të kolonive të Italisë e të Greqisë, që i përkisnin diasporës mesjetare shqiptare, dhe atyre të kolonive më të reja të Rumanisë, Bullgarisë, të SHBA, të Stambollit, ekzistonte një sintoni e përkryer për sa i përket temave kryesore të Lëvizjes Kombëtare: një shkollë kombëtare, alfabet e gjuhë të unifikuar, pavarësim nga sundimi shekullor osman, shtet i njësuar, sistem republikan, orientim evropian.

Por nuk mungoi edhe ndonjë ndjeshmëri e ndryshme për ndonjë temë tjetër të rëndësishme, siç ishte ajo e raportit me besimin fetar. Shqiptarët e Shqipërisë ishin futur në shek. XX të ndarë në tre, madje në katër, besime të konstituara. Një pjesë e madhe e tyre ishin myslimanë sunitë, të tjerë i përkisnin urdhërit bektashi dhe një pjesë tjetër e madhe e popullsisë ruante besimin e krishterë, të ndarë në të krishterë katolikë e të krishterë ortodoksë. Kështu, pra, feja nuk mund të luante rolin e një faktori bashkimi e kohezioni kombëtar, siç e luante në rastin e grekëve dhe të popujve sllavë të Ballkanit. Përkundrazi, ajo mund të kthehej në një faktor ndarjeje, në momentin kur kërkohet një Shqipëri e bashkuar mbi bazën e kriterit etnik. Për të kapërcyer këtë pengesë serioze, katoliku Pashko Vasa, në vitin 1879, u bëri thirrje bashkëpatriotëve të tij të të gjitha besimeve, që t’i kthenin sytë nga një besim i ri, që ai e quajti “shqiptaria”<sup>36</sup>. Mund të mendohet që kjo të ishte një variant shqiptar i “apostolatit të ri” të Giuseppe Mazzinit<sup>37</sup>, apo edhe një jehonë e “fesë së

<sup>35</sup> S. J. Woolf, *Storia d'Italia ...*, f. 312.

<sup>36</sup> V. Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët ...*, f. 4-6.

<sup>37</sup> S. J. Woolf, *Storia d'Italia ...*, f. 354.

re” të shpallur nga iluministët francezë<sup>38</sup>. Fakti është se në Shqipëri ishte formuar tashmë vetëdija që feja nuk mund të ishte një element identitar. Duheshin kapërcyer barrierat fetare, për t’u mbledhur të gjithë bashkë, mbi bazën e njësisë së gjuhës, të kulturës, të traditave dhe, më në fund, të qëllimeve. Për këtë gjë bënë thirrje Pashko Vasa, Sami Frashëri, Jani Vreto dhe arbëreshi Anselmo Lorecchio. Ky i fundit, drejtor i gazetës “La Nazione Albanese”, shkruante në vitin 1897:

“Gjithë sa jemi Shqiptarë mbi këtë tokë, i përkasim të gjithë të njëjtit gjak, flasim të njëjtën gjuhë. Ndaj, le të bashkohemi, vëllezër shqiptarë, le të mos jenë besimet e ndryshme shkak për grindje mes nesh. Le mos t’i zemë besë të huajve, mos t’i zemë besë shërbyesve të ndryshëm të fesë. Zoti dhe Allahu, Muhameti e Krishti na tregojnë vetëm një rrugë: ta ruajmë të bashkuar e të respektuar atdheun tonë”<sup>39</sup>.

Sigurisht, Lorecchio, një liberal e antiklerikal i lidhur me mjediset politike italiane, mund ta përdorte një gjuhë të tillë. Por nuk ishin në një mendje me të të gjithë arbëreshët. Në fakt, ndryshe nga ç’ndodhte me shqiptarët e Shqipërisë, besimi fetar përjetohej nga arbëreshët e Italisë si një faktor identitar i dorës së parë. Mbijetesa e tyre i detyrohej shumë ruajtjes prej tyre të ritit bizantino-ortodoks, i cili i bënte ata të ndryshëm dhe të pa asimilueshëm nga mjedisi katolik italian që i rrethonte<sup>40</sup>. Të vetëdijshëm për rëndësinë që kishte feja tek arbëreshët, studiues të njohur të tyre, si At Giorgio Guzzetta e P. Rodotà, i kushtuan vëllime të tëra studimit të ritit ortodoks ndër bashkësitë arbëreshe<sup>41</sup>.

Kështu, pra, arbëreshët e përjetonin me një tjetër intensitet problemin e besimit fetar. Sipas Vincenzo Dorsas, “edhe familja, edhe atdheu e shoqëria duhen sakrifikuar përballë thirrjes së besimit”<sup>42</sup>. Një deklaratë të tillë nuk do ta miratonte asnjëri prej agjitorëve të çështjes shqiptare në Shqipëri.

Besimi i të parëve ishte diçka e shtrenjtë edhe për Jeronim de Radën, përfaqësuesi më i shquar arbëresh i Rilindjes Kombëtare, shkrimtar,

<sup>38</sup> Egon Friedell, *Kulturgeschichte der Neuzeit*, München: C. H. Beck, 1989, f. 725-726.

<sup>39</sup> F. Guida, “Ricciotti Garibaldi ...”, f. 107.

<sup>40</sup> Vincenzo Dorsa, *Su Gli Albanesi. Ricerche e pensieri*, 1847 (botimi shqip, Tiranë: Botimet Enciklopedike, 2010, f. 205).

<sup>41</sup> P. G. Guzzetta, *L’osservanza del rito ...*; P. P. Rodotà, *Dell’origine, progresso e stato presente del rito greco in Italia*, 3 vol., Roma 1758.

<sup>42</sup> V. Dorsa, *Su Gli Albanesi ...*, (botimi shqip, f. 134).

publicist e patriot i radhëve të para, mik besnik i të gjithëve: i katolikut Pashko Vasa, i myslimanit Sami Frashëri dhe i ortodoksit Jani Vreto. Me ta u hodh me mish e me shpirt në luftën për pavarësinë dhe për bashkimin e Shqipërisë, aq sa më 25 korrik 1878 iu drejtua vetë Mbretit Umberto I të Italisë, duke e lutur që të ndërhynte për të siguruar pavarësinë dhe njësinë e “motrës Shqipëri”, që dergjej në kushtet e një skllavërie të padurueshme<sup>43</sup>.

E pra, edhe De Rada e kishte një mendim të fshehtë, të cilin deshi ta bëjë publik vetëm në çastet e fundit të jetës së tij. Në testamentin politik të botuar në “La Nazione Albanese” më 30 shtator 1902, De Rada rrëfen si dëshirë dhe shpresë të tij “përhapjen së shpejti të Fjalës së Zotit në Turqi, e cila do fillojë me kthimin e shqiptarëve në fenë e të parëve”<sup>44</sup>. Kjo ide e riungjillëzimit të Shqipërisë nuk përkiste me frymën laike, herë-herë ateiste, të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ishte një ide “heretike”, po të krahasohej me parimin e pranuar bashkarisht, sipas të cilit besimi fetar duhej t’i nënshtrohej interesave të atdheut.

E megjithatë, një ide e tillë pati ndjekësit e saj edhe në Shqipëri. Atë e formuloi dhe e shtjelloi në mënyrë të qartë, në një lloj *memorandumi* të titulluar “Çështja kombëtare dhe çështja katolike”, ati françeskan, Gjergj Fishta<sup>45</sup>. Pasi flet për karakterin e sipërfaqshëm të besimit mysliman në Shqipëri, i cili ishte dobësuar akoma më shumë pas rënies së kalifatit dhe pas organizimit të islamit shqiptar mbi bazë kombëtare, në vitin 1923, at Fishta propozonte organizimin e një aksioni strategjik të kishës katolike, i cili duhej të fillonte nga Shqipëria dhe duhej të sillte rikthimin e shqiptarëve në fenë e krishterë dhe shtrirjen e besimit katolik në gjithë Ballkanin, deri në Stamboll. Lidhur me rikonvertimin e myslimanëve shqiptarë, Fishta mendonte se një gjë e tillë do të mund të përfundonte brenda dy ose tre breznive. Hartimi i këtij dokumenti interesant zgjati plot dhjetë vjet (1914-1924). Me sa duket autori nuk nxitoi ta përfundojë studimin përpara se të përfundonin Luftërat Ballkanike, që sollën

---

<sup>43</sup> Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo: A. C. Mirror, 2003, f. 222.

<sup>44</sup> *Po aty*.

<sup>45</sup> Shaban Sinani, “Besimi dhe kombësia në një vepër të pabotuar të at Gjergj Fishtës”, në: *Mendimi Shqiptar dhe Shkolla Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Aktet e Konferencës, Tiranë: 29 maj 2009, “Plejad”, Tiranë, 2009, f. 233-236.

kolapsin e Perandorisë Osmane, si dhe Lufta e Parë Botërore dhe Konferenca e Paqes së Versajës, nga të cilat, me sa duket, ka pritur që t'i hapej rrugë realizimit të idesë së tij. Ishte një material i destinuar për të mbetur sekret, dhe në fakt nuk u botua kurrë. Kopja e vetme e tij u gjet së fundi në Arkivin e Shtetit.

Rikthimi i shqiptarëve në fenë e krishterë ishte njëri nga ato “mendimet e fshehta”, për të cilat kisha katolike në Shqipëri, dhe at Gjergj Fishta si eksponenti kryesor i saj, u akuzuan shpesh nga kundërshtarët e tyre<sup>46</sup>. Ideja e një kthimi masiv në besimin katolik binte në kundërshtim me ideologjinë e Lëvizjes Kombëtare, e cila kishte përcaktuar një prioritet tjetër, interesin kombëtar, dhe në këtë kuadër ishte përpjekur ta relativizonte në maksimum rolin e fesë<sup>47</sup>. Në këtë vështrim, statistikën me bazë fetare, raportet fetare dhe aq më shumë, ndryshimi i raporteve fetare, ishin për rilindasit një tasto e rrezikshme, që assesi nuk duhej prekur. Nëse ky tekst i Fishtës do të ishte botuar, me siguri do të kishte shkaktuar një furtunë të vërtetë. Projekti i At Gjergj Fishtës risillte epokën e kryqëzatave dhe nuk do ishte përjetuar ndryshe, veç si një dhunim, si një thyerje marrëveshjeje, si një tradhti ndaj çështjes kombëtare, e cila predikonte bashkimin e mbështetur në respektin reciprok të besimeve fetare dhe në ekzaltimin e interesit suprem të atdheut. Me sa duket, këtë e dinte mirë edhe vetë Fishta, ndaj edhe e mbajti të fshehur elaboratin e tij.

Më herët, kisha katolike kishte bërë autokritikë për mosdëshirën e shprehur nga disa eksponentë të saj për të bashkëjetuar në një shtet të njësuar me shumicë myslimane, duke anuar nga opsioni i një shteti të ndarë në kantone<sup>48</sup>. Pas krijimit të shtetit shqiptar, pati edhe klerikë katolikë që u përfshinë ose që drejtuan deri rebelime të karakterit fetar, siç ishin ato të Shkodrës më 1920, apo të Mirditës më 1921 dhe që synonin krijimin e një “republike katolike autonome”. Fatmirësisht, në njerin dhe në tjetrin rast, krerët e kishës katolike në Shqipëri qëndruan larg dhe i denoncuan lëvizje të tilla<sup>49</sup>.

Gjithsesi, ishin të shumtë katolikët, sa laikë aq edhe klerikë, si Pashko Vasa, Hil Mosi, Ndre Mjeda, Nikoll Kaçorri etj., të cilët, në

<sup>46</sup> Nikolla Ivanaj, *Historia e Shqipëniës së Re*, Pjesa II: Shqipëria e kleri katolik, Tiranë: “Bashkimi”, 1945, f. 11.

<sup>47</sup> Rexhep Qosja, *La question albanaise*, Paris: “Fayard”, 1995, f. 19.

<sup>48</sup> N. Ivanaj, *Historia e Shqipëniës...*, Pjesa II, f. 31-32.

<sup>49</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 307.

respekt të individualitetit të gjithësecilit, përçuan në popull mesazhin e Rilindjes, duke predikuar bashkimin e vëllazërimit midis të krishterëve e myslimanëve, midis gegëve të Veriut dhe toskëve të Jugut<sup>50</sup>. Të ndërgjegjshëm për paragjykimet që rrethet evropiane kishin ndaj myslimanëve shqiptarë, të gjithë ata luftuan për të ngritur, përpara tyre, figurën e myslimanit shqiptar, si njeri tolerant, patriot dhe evropian. Në këtë frymë, në vitin 1911, në një konferencë të mbajtur në Shoqatën e Gazetarëve në Romë, Nikollë Ivanaj do të deklaronte:

“Evropa e ashtuquajtur e qytetëruar i gjykon myslimanët shqiptarë të ndryshëm nga ata të krishterë. Por kjo është fare e padrejtë, pasi shqiptarët edhe në qofshin me fe të ndryshme, janë gjithnjë vëllazër dhe kanë tradita, zakone e gjuhë të përbashkët. Madje dua të theksoj, se shqiptarët myslimanë janë më të mësuar se ata të krishterë dhe se vetë banorët e Kosovës, që mbahen për të egër e injorantë, janë sot më të moralshëm dhe më nacionalistë se shumë shkodranë katolike”<sup>51</sup>.

Me më shumë tharm shtrohej nga patriotët shqiptarë problemi i klerit. Marrëdhënia e këtij të fundit me çështjen kombëtare kishte qenë shumë e vështirë dhe kontradiktore. Kleri mysliman, në një pjesë shumë të madhe i kishte qëndruar deri në fund besnik idesë së Perandorisë Osmane. Nga ana e tij, kleri katolik e kishte të vështirë të bashkonte parimin universal të kishës me atë të shtetit kombëtar, që veç të tjerash nënkuptonte edhe një kishë kombëtare. Një rast ekstrem përfaqësonte kleri ortodoks. Për eksponentët kryesorë të këtij të fundit, që jo rastësisht ishin me origjinë greke, ortodoksit shqiptarë ishin pjesë e “popullit ortodoks grek” dhe kisha ortodokse në Shqipëri nuk mund të ishte veçse një kishë greke. Ky keqinterpretim ishte rrënjësor thellë në shekujt e sundimit osman falë veprimit të Patrikanës së Stambollit, të mbështetur gjithashtu nga Porta e Lartë. Kjo ishte arsyeja përse krerët grekë të Kishës Ortodokse Shqiptare refuzonin të njihnin ekzistencën e një kombi shqiptar, dhe aq më pak të një shteti shqiptar. Emblematik është në këtë drejtim shembulli i metropolitit grek të Durrësit, Jakobit, i cili në 23 nëntor 1912, bashkëpunoi me autoritetet osmane për të penguar ngritjen e

<sup>50</sup> V. Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët ...*, f. 97, 101; *Mendimi Politik e Shoqëror i Rilindjes ...*, f. 117, 168; Mentor Quku, *Mjeda*, vëll. I, Tiranë: “Ilar”, 2004, f. 523; *Po aty*, vëll. II, Tiranë: 2006, f. 129, 323; *Po aty*, vëll. III, Tiranë: 2007, f. 55, 56, 70, 72, 450.

<sup>51</sup> N. Ivanaj Bey, *Conferenza tenuta in Roma...*, f. 15.

flamurit shqiptar në Durrës<sup>52</sup>. Për këtë arsye, pas Shpalljes së Pavarësisë në 1912, shpallja e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare në vitin 1922, u përjetua si një vazhdim e plotësim i Pavarësisë së arritur më 28 Nëntor 1912.

Italia e Risorgimentos i magjepsi shumë nga ideologët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Njëri prej tyre, Pashko Vasa, e pohonte vetë më 1850, se ishte dashuria e tij për Italinë, përveç dashurisë për drejtësinë, ajo që e shtyu të bashkohej me Revolucionin e Venecias, më 1848<sup>53</sup>. Miku i tij, njëherësh edhe bashkautor i programit të parë politik të Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri, ishte i bindur se Italia, vendi që kishte strehuar 300 mijë shqiptarë, ishte garancia më e mirë për integritetin territorial të shtetit të ardhshëm shqiptar: “Ajo nuk do ta lejonte kurrë, që Shqipëria të coptohej mes grekësh e sllavësh”<sup>54</sup>. Në fakt, Italia ishte vendi që kishte mirëpritur një masë të madhe të ikurish shqiptarë pas shek. XV, vendi që lejoi dhe mbështeti botimin e gazetave, shpërndarjen e lajmeve, organizimin e shoqatave dhe të veprimtarive në mbrojtje të kauzës shqiptare, në kapërcim të shek. XIX-XX. Mbi këto premisa mund të kuptohet gjesti i një patrioti shqiptar, i cili në vitin 1920, atëherë kur Konferenca e Paqes e Parisit diskutonte mbi rikonfigurimin e territoreve shqiptare, u gjunjëzua përpara sekretarit të Jashtëm të Italisë, princit Scalea, duke i drejtuar me lotë në sy lutjen: “*Excellence, sauvez-nous la Ciamuria*”<sup>55</sup>. Episodi tregon se sa të mëdha ishin pritshmëritë kundrejt Italisë. Dhe në fakt, Italia luajti një rol të dorës së parë si në themelimin e shtetit shqiptar më 1912, ashtu edhe në periudhën e mëvonshme. Por, për sa i përket problemit specifik të integritetit territorial të shtetit shqiptar pas 1912, politika italiane u luhat midis konsensusit për një ndarje të territoreve shqiptare mes grekëve, malazezëve, serbëve dhe vetë italianëve, duke lënë një shtet shqiptar fare të vogël e të dobët, dhe idesë për njohjen e një shteti shqiptar në kufijtë e përcaktuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 1913. Përsa i përket zgjidhjes së parë, ajo njohu çastin më të errët me rastin e marrëveshjes Tittoni-Venizelos të vitit 1920, e cila u përjetua nga

<sup>52</sup> Ilira Çaushti-Sulo, “Klerikët e harruar të Pavarësisë”, në: *Pavarësia e Shqipërisë...etj.*, f. 88.

<sup>53</sup> P. Vasa, *La mia prigionia ....*

<sup>54</sup> S. Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është ...”, f. 60.

<sup>55</sup> E. Bey Vlora, *Lebenserinnerungen...*, Band. II, f. 20.

shqiptarët si një goditje pas shpinës pikërisht nga vendi, i cili pas shpërbërjes së Austro-Hungarisë, konsiderohej si mbrojtësi i vetëm i interesave shqiptare. Ky gjest diplomatik, që për fat nuk pati efekte në terren, provokoi ndaj Italisë irritim e mëri, që lanë shënjën e tyre në marrëdhëniet italo-shqiptare. Për sa i përket zgjidhjes së dytë, ruajtjes së një Shqipërie në kufijtë e përcaktuar më 1913, kjo u mbrojt me koherencë pas vitit 1920 nga ministri i Jashtëm italian, Carlo Sforza, duke u kthyer paskëtaj në boshtin qendror të politikës italiane kundrejt Shqipërisë<sup>56</sup>. Një politikë e tillë, e vlerësuar si dashamirëse në Shqipëri, njohu aktin e saj sublim me rastin e rënies së gjeneral Tellinit, i cili u vra nga agjentë grekë, ndërsa po përfundonte misionin e tij për përcaktimin në terren të kufijve mes Greqisë e Shqipërisë, ashtu si ata ishin përvijuar përfundimisht nga Lidhja e Kombeve<sup>57</sup>.

Pra, do të ishte me vend të merrej në konsideratë edhe ana tjetër e politikës italiane ndaj Shqipërisë, e cila, siç pohon M. Dogo, në shumë raste tregoi se ishte “e dizinformuar, e çorientuar dhe jo koherente”<sup>58</sup>. Deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore, kjo politikë i ngjau më shumë një loje mbulimi dhe ekuilibrimi të Austro-Hungarisë. Me shkrirjen e Perandorisë Habsburge, Italia zuri një pozicion dinamik e sulmues: Shqipëria u përfshi në sferën e interesave të privileguara të Italisë, në rolin e një “kryeure drejt Ballkanit, e një thike pas shpine, e një baze ekspansioniste në dëm të vendeve fqinje”<sup>59</sup>.

Pas bashkimit të Italisë, më 1871, politika e jashtme italiane mban vulën e Francesco Crispi, i cili ishte përfaqësuesi më i lartë politik i arbëreshëve të Italisë. Mu për këtë arsye, Crispi u pa si shpresa e madhe nga ana e veprimtarëve shqiptarë të çështjes kombëtare. Më 25 shtator 1888, kreu politik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, iu

---

<sup>56</sup> Luca Micheletta, “La lotta per il “limes” greco-albanese e l’eccidio Tellini”, në: *Il caso Tellini: dall’eccidio di Janina all’occupazione di Corfù*, a cura di O. Ferrajolo, Istituto di Studi Giuridici Internazionali, Milano: Giuffrè Editore, 2005, f. 67-81.

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> M. Dogo, “Anno 1927: Propaganda, spionaggio e sovversione nella partita italo-jugoslava per l’Albania”, në: *Studi Balcanici*, pubblicati in occasione del VI Congresso Internazionale dell’Association Internationale d’Études Sud-Est Européennes (AIESEE), Sofia, 30 agosto - 5 settembre 1989, a cura di F. Guida-L. Valmarin, Roma: “Carucci editore”, 1989, f. 205.

<sup>59</sup> Po aty, f. 205.

drejtua pikërisht atij me këto fjalë: “Të jeni i sigurt, Shkëlqesi, se Shqipëria nuk do ta harrojë kurrë që ua detyron pikërisht Juve ekzistencën dhe pavarësinë e saj”<sup>60</sup>. Por, kjo ishte një pritmëri, e cila nuk pati rast të vërtetohej në praktikë. Pak rëndësi pati origjina shqiptare e Crispit. Politika e jashtme e tij mbarte shenjën e Mazzinit, ishte antiaustriake dhe, për rrjedhojë, filogreke e filoslave: “Tiparet kryesore të politikës italiane, kur Italia do të bëhet”, shkruante Crispi, “duhet të jenë sllavo-greke”<sup>61</sup>. Qysh nga fillimi i karrierës së tij politike, e deri në fund të jetës, Crispi nuk e trajtoi kurrë çështjen shqiptare si një problem më vete. Nuk pranoi, madje, as të flasë për një komb shqiptar, ndërkohë që u njihte grekëve, serbëve, bullgarëve, rumunëve madje edhe maqedonëve të drejtën për të patur shtetin e tyre kombëtar<sup>62</sup>. Thirrjet përgjëruese që i drejtuan atij patriotët shqiptarë, mbetën pa përgjigje. Në fakt, ngjarjet që ndodhnin në Shqipëri pasqyroheshin gjerësisht në gazetën e tij “La Riforma”, por gjithnjë në një perspektivë anti-austriake. Por asnjë fjalë nuk u shpenzua për programin kombëtar, pavarësisht se Rilindja Shqiptare zhvillohej në të njëjtat linja kryesore si Risorgimento Italiano, që pati për protagonist të saj edhe vetë Francesco Crispin. Nuk u fol kurrë prej tij për mbrojtjen e territoreve shqiptare të kërcënuara nga grekët e sllavët. Jo më kot Crispi u bë kryetar i komitetit filohelen dhe e shfrytëzoi çdo rast, çdo fjalim parlamentar e çdo dalje publike për të promovuar një “Greqi të Madhe”, e cila nuk mund të realizohej, veç në dëm të Shqipërisë<sup>63</sup>.

Nga ana tjetër, Crispi duket se kishte përqafuar idenë e formuluar nga Mazzini më 1857 dhe të shprehur në “letrat sllave” të tij, mbi krijimin e një Federate të Krishterë Ballkanike, që të kishte për kryeqytet Konstandinopojën dhe si “popull themelues” të kishte pikërisht grekët: “Evropa e ardhshme do të ketë...një Greqi, e cila do të shtrihet deri në malet Ballkan dhe do të ulet në Konstandinopojë, e cila do të jetë kryeqyteti i lirë i një konfederate popujsh, i atyre popujve që sot përbëjnë Perandorinë Turke në Evropë”<sup>64</sup>. Ishte mbështetës i vendosur i një

<sup>60</sup> *Akte të Rilindjes Kombëtare ...*, f. 122-123.

<sup>61</sup> N. Ivanay Bey, *Conferenza tenuta in Roma ...*, f. 25.

<sup>62</sup> Bruno Lavagnini, *Grecia 1859 nel diario di Francesco Crispi*, Istituto Siciliano di Studi Bizantini e Neoellenici, Palermo: 1967, f. 8-10.

<sup>63</sup> Th. Palamenghi-Crispi, *The Memoires of Francesco Crispi*, vol. III, Hodder and Stoughton, London: 1914, f. 272; Costas Kerofilas, *La Grecia e l'Italia nel Risorgimento italiano*, Firenze: Libreria della Voce, 1919, f. 59-69.

<sup>64</sup> B. Lavagnini, *Grecia 1859 ...*, f. 8.

aleance të popujve ballkanikë, e cila në vizionin e tij do të kishte një funksion antiaustriak dhe antiturk<sup>65</sup>. Aleanca ballkanike u ndërtua, në fakt, në vitin 1912, por objektivi i saj kryesor rezultoi të ishte pikërisht shpërbërja dhe copëzimi i shtetit të porsalindur shqiptar. U rreshtua në anën greke edhe në polemikën që u zhvillua midis historianit gjerman J. Ph. Fallmerayer dhe botës greke të shkencave e të politikës mbi problemin aq të ndjeshëm të vazhdimësisë biologjike mes grekëve modernë dhe grekëve të lashtë. Dhe mu për këtë arsye, u përfshi në listën e “filohelenëve”<sup>66</sup>. Dhe, më në fund, nuk mund të shpëtojë fakti që në gazetën e Crispi “La Riforma”, shqiptarët quhen shpesh me emrin “Arnautë”, një term i përdorur me përçmim nga sllavët e grekët për të treguar myslimanët shqiptarë<sup>67</sup>. Siç duket, Crispi e kishte të vështirë të pranonte faktin se pjesa më e madhe e shqiptarëve kishin kaluar në fenë islame. Urrejtja e deklaruar e tij për Perandorinë Osmane dhe për Islamin, në përgjithësi<sup>68</sup>, duhej të përfshinte edhe myslimanët shqiptarë. Në një intervistë për gazetën “Le Figaro”, më 1897, Crispi tregon se nuk shihte vend për myslimanët në Konfederatën e ardhshme Ballkanike, që do të krijohesh pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane<sup>69</sup>.

Por, cila do të ketë qenë zgjidhja që Crispi ka menduar për Shqipërinë? Bashkim me Greqinë, siç edhe e la të kuptohesh gjatë një mitingu të tij në Athinë më 1857?<sup>70</sup> Në fakt, një tjetër personalitet i shquar i letrave, arbëreshi Demetrio Camarda ishte shpallur hapur për bashkimin e grekëve dhe të shqiptarëve në një shtet të përbashkët<sup>71</sup>. Nuk është thjesht një rastësi, që të njëjtën ide e shprehte atë kohë (1860) edhe arbëreshi (arvanitasi) nga Greqia, Anastas Byku, botues i gazetës “Pelagos”, që dilte në Lamia të Greqisë, dhe që të ardhmen e shqiptarëve nuk e shihte në organizimin e tyre si një komb e si një shtet kombëtar, por në shkrirjen e tyre në gjirin e “helenizmit”. Në fund të fundit, në gjysmën e dytë të shek. XIX, nga historiografia e politizuar greke po mbrohej me forcë teza sipas së cilës grekët e shqiptarët ishin degë të së

<sup>65</sup> Th. Palamenghi-Crispi, *The Memoires of Francesco Crispi*, vol. III, Hodder and Stoughton, London 1914, f. 272, 276.

<sup>66</sup> B. Lavagnini, *Grecia 1859 ...*, f. 25.

<sup>67</sup> *La Riforma*, 16 settembre 1878.

<sup>68</sup> Th. Palamenghi-Crispi, *The Memoires ...*, vol. III, f. 285.

<sup>69</sup> *Po aty*.

<sup>70</sup> B. Lavagnini, *Grecia 1859 ...*, f. 10.

<sup>71</sup> G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese ...*, f. 250.

njëjtës popullsi të lashtë, të pellazgëve<sup>72</sup>. Por përtej tezës së origjinës së përbashkët, në rastin e Camardas e të Bykut ideja e shtetit të përbashkët greko-shqiptar merr shkas më së shumti nga paragjykimi fetar, i cili i mbivendoset idesë kombëtare, dhe kjo është arsyeja përse ideja e bashkimit të shqiptarëve me grekët në një shtet të përbashkët shkaktoi reagimin e ashpër të rilindasve shqiptarë<sup>73</sup>.

Mund të shtrohet edhe pyetja tjetër: a mos vallë Crispi parashikonte një bashkim të Shqipërisë me Italinë? Ai nuk u shpreh mbi këtë çështje, por drejtori i gazetës “La Nazione Albanese”, Anselmo Lorecchio, mik i Crispi dhe arbëresh si ai, e rivendikonte hapur të drejtën e Italisë për të aneksuar Shqipërinë, në rast se kjo do të bëhej e domosdoshme “për të ruajtur ekuilibret evropiane”<sup>74</sup>. Lorecchio sillte si argument mbështetës edhe faktin që Shqipëria ishte atdheu i dytë për arbëreshët e Italisë. Bën përshtypje, që një arsyetim të tillë bënte më 1770 edhe At Giorgio Guzzetta, i cili shkruante atë kohë një memorandum për Mbretin e Napolit me titullin kuptimplotë: “Mbi të drejtat që kanë mbretërit e lavdishëm të Siqilisë mbi Shqipërinë, shkak për të cilin mund të quhen akoma sot mbretër dhe despotë të saj”.

Sidoqoftë, vetë Crispi rrëfen, se gjatë takimit që pati në Bad Gastein, më 17 shtator 1877, me princin Bismark, ky i kishte propozuar atij aneksimin e Shqipërisë nga ana e Italisë<sup>75</sup>. Me siguri, themeluesit të politikës koloniale italiane i ka ardhur mirë për këtë propozim. Por zbatimi i tij, qoftë për dobësitë e brendshme, qoftë për marrëdhëniet delikate me Austro-Hungarinë për shkak të çështjes së Adriatikut Lindor, u shty për kohë të tjera. Por, ndërsa Crispi ruhej të shprehej për çdo çështje që kishte të bënte me Shqipërinë dhe kombin shqiptar, Perandoria

<sup>72</sup> Thomas Paschides, *Oi Albanoi kai to mellon auton en to Ellenismo*, Athena: 1879.

<sup>73</sup> Për t’u përmendur është polemika që zhvilluan më 1857 Thimi Mitko me Anastas Bykun, botuesin e gazetës “Pelagos”. Shih: Aleks Buda, “Të dhëna mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vitet 1859-1861”, në: *Studime Historike*, 2, 1965; Zihni Reso, “Lufta e popullit shqiptar për shkrimin dhe shkollën shqipe në shtypin e Rilindjes sonë Kombëtare”, në: *Alfabeti...*, f. 15.

<sup>74</sup> Oreste Camillo Mandalari, *Indipendenza shqiptare. Ndihmesa italiane në dritën e dokumenteve*, Tiranë: “Uegen”, 2008, f. 56.

<sup>75</sup> Francesco Crispi, *Politica estera. Memorie e Documenti*, raccolti e ordinati da T. Palamenghi-Crispi, vëll. I, Milano: Fratelli Treves Editori, 1929, f. 27; *La Riforma*, 13 agosto 1878.

Austro-Hungareze, qysh prej vitit 1877, kishte marrë përsipër të përfaqësonte interesat kombëtare shqiptare, duke hedhur e para idenë e krijimit të një shteti të pavarur shqiptar<sup>76</sup>. Sa për Crispin, i përket këtij ish-revolucionari internacionalist të konvertuar në një nacionalist konservator (“Isha revolucionar për të bërë Italinë, u bëra konservator për ta ruajtur atë”),<sup>77</sup> merita e përpunimit të një politike, që synonte ta bënte Italinë një fuqi të madhe koloniale<sup>78</sup>. Jo më kot fashizmi e shpalli atë apostullin e vet<sup>79</sup>. Politika e Crispit ndaj Shqipërisë, me heshtjen befasuese të tij ndaj problemit të pavarësisë e integritetit të shtetit shqiptar, shërbeu si një lloj uverture e pushtimit fashist të vitit 1939.

Në këtë pikë, nuk mund të mos konstatohet se sa larg jemi nga lloji i marrëdhënieve që veprimtarët e Rilindjes Shqiptare kishin dashur të ndërtonin me Italinë fqinje.

Në fund të fundit, kishte rezultuar një marrëdhënie e karakterizuar nga keqkuptime të shumta. I vetmi aspekt dinamik e konkret i politikës italiane drejt Shqipërisë dhe Ballkanit, në kapërcim të shekujve XIX-XX, u përfaqësua nga aksionet aventureske të Ricciotti Garibaldit, ku morën pjesë edhe shumë arbëreshë. Mirëpo, shumë prej tyre i kuptuan Luftërat Ballkanike të asaj periudhe si luftëra fetare të të krishterëve kundër “barbarëve” myslimanë<sup>80</sup>. Kujtojmë se i njëjti paragjykim fetar kishte shtyrë personalitete të shquara arbëreshë, si në rastin e Demetrio Camardas, të kërkonin një bashkim të shqiptarëve me grekët në të njëjtin shtet, ku të dytët do të kishin statusin e “kombit themelues”, e pra, të preferuar. Kështu, më 1878, 1911 apo më 1913, vullnetarët garibaldinë arbëreshë që u hodhën përtej detit, nuk arrinin ta kuptonin se “myslimanët” kundër të cilëve shkonin të luftonin në malet e Epirit, ishin shqiptarë si ata vetë<sup>81</sup>. Nga ana e tij, Ricciotti Garibaldi, i cili nga viti 1900 kishte

<sup>76</sup> Benedict H. Sumner, *Russia and the Balkans 1870-1880*, London: “Archon Books”, 1962, f. 584-585; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, vëll. I (1867-1912), Tiranë: 1984, f. 119.

<sup>77</sup> F. Crispi, *Politica estera ...*, vol. I, 1929, f. 67; S. Romano, *Crispi*, Milano: “Bompiani”, 1986, f. 90.

<sup>78</sup> Gaetano Petrotta, *Francesco Crispi e l’Albania*, Palermo: 1927, f. 7.

<sup>79</sup> S. Romano, *Crispi ...*, f. 277.

<sup>80</sup> O. C. Mandalari, *Indipendenza shqiptare ...*, f. 128.

<sup>81</sup> Miltiades D. Seizanes, *E politike tes Hellados kai e epanastasis tou 1878*, Athenai: 1878, f. 131-132; M. Brunetti, “Il Risorgimento, una rivoluzione

filluar të interesohej për çështjen shqiptare (më 1904 u zgjodh edhe si kryetar i Komitetit Kombëtar Shqiptar), e konsideronte atë çështje si pjesë të një zgjidhjeje federaliste për popujt e Ballkanit, me orientim të qartë antiaustriak. Më kot u mundua bashkëpunëtori i tij arbëresh, Manlio Bennici, ta bindëte për ta braktisur idenë e federatës ballkanike dhe t'i përkushtohej vetëm çështjes shqiptare<sup>82</sup>. Dhe kështu iu hap rruga keqkuptimeve të shumta, dhe në një moment të caktuar, vullnetarët arbëreshë që u ishin bashkuar trupave të Ricciotti Garibaldit me dëshirën për të kontribuar në çlirimin e vëllezërve shqiptarë nga zgjedha osmane, u gjendën krah për krah me trupat “e krishtera”, greke e serbe, që luftonin pikërisht për pushtimin e qyteteve dhe fshatrave shqiptarë. Ky fakt shkaktoi një diziluzion e dëshpërim të madh tek patriotët shqiptarë, duke filluar nga Faik Konica, i cili nuk mungoi ta denoncojë atë në faqet e revistës “Albania”<sup>83</sup>.

Por ndaj këtij keqkuptimi fatal reagoi edhe vetë Benito Mussolini, atëhere socialist, në një artikull fshikullues të botuar në gazetën “Avanti!” të datës 16 nëntor 1912:

---

conservatrice”, in: *Il Risorgimento una rivoluzione conservatrice*, Istituto Mezzogiorno-Mediterraneo, Catanzaro: 2012, f. 51.

<sup>82</sup> F. Guida, “Ricciotti Garibaldi ...”, f. 99.

<sup>83</sup> Shih artikullin “Ricciotti Garibaldi, le foudre de guerre” shkruar nga F. Konica, në: *Albania*, viti III, nga 15 në 30 prill 1899, f. 98-99: “Ricciotti faisait annoncer partout qu’il était prêt à courir au secours de la Grèce avec 200. 000 “garibaldiens”. En lisant cette declaration dans les journaux, j’ai pali; je me suis dit: l’appui de Ricciotti fera infailliblement tomber l’Albanie meridionale aux mains de la Grece...La guerre declarée, Ricciotti partit pour la Grece, mais avec 200 “garibaldiens”, oui avec 200 seulement!...Ricciotti n’est pas seulement ridicule. Ricciotti est incoherent au supreme degre. Il n’y a pas deux ans, il allait combattre avec les Grecs qui avaient declare la guerre à la Turquie dans le but de s’emparer de l’Albanie. Ricciotti, maintenant, declare vouloir combattre avec les Albanais contre tous ceux qui veulent conquerir l’Albanie, donc aussi contre les Grecs. Quelle contradiction grossiere”! Shih gjithashtu edhe artikullin tjetër po të F. Konicës, në: *Albania*, viti III, nr. 11, Bruxelles, 30 nëntor 1899, f. 31: “Qu’est-ce que ce journal “La Nazione Albanese” veut prouver aux Albanais? Peut-etre que l’Italie veut aider les Albanis à recouvrer leur independence nationale? Mais pendant les annees 1880-1884 les Garibaldiens et leurs amis politiques en Italie n’ont fait que traiter tour à tour avec les Grecs et les Serbes pour envahir l’Albanie et y faire la guerre. Et qui aurait eu les profits d’une telle guerre? Evidement les Grecs ou les Serbes, ou peut-etre les Italiens ou tous les trois, mais jamais les Albanais”.

“Ja pra, vullnetarët garibaldinë, të cilët deri para pak muajsh digjeshin nga dashuria për Shqipërinë, ata vullnetarë garibaldinë që vetëm një vit më parë kishin ideuar dhe përgatitur një ekspeditë në Shqipëri, po ata garibaldinë italianë bashkëpunojnë sot me Aleancën Katërpalëshe për të coptuar Shqipërinë. Në këtë keqkuptim absurd, pra, vdiq një legjendë”<sup>84</sup>.

Dhjetë vjet më vonë, me të ardhur në pushtet, i njëjti Benito Mussolini e shtroi problemin shqiptar në termat e dilemës hamletiane: “Ose ta bëjmë të fortë, ose ta bëjmë tonën”<sup>85</sup>. Prej këtyre dy zgjedhjeve, vendosi për të dytën<sup>86</sup>.

E megjithatë, kishte rreze drite edhe në këtë Itali “të keqe”, që e shihte Shqipërinë si një koloni të thjeshtë të saj. Mjafton të kujtojmë se sa thellë janë ngulitur në kujtesën e shqiptarëve ngjarje, si manifestimet e fuqishme të punëtorëve italianë, të cilat më 1920 e detyruan qeverinë të tërhiqte trupat e pushtimit nga Vlora. Le të kujtojmë gjithashtu bashkimin, më 1943, të ushtarakëve të shumtë antifashistë italianë me forcat e rezistencës partizane shqiptare. Bëmat dhe sakrificat e luftëtarëve italianë, të organizuar në një batalion që mbante emrin e një personaliteti të shquar të Italisë, arbëresh edhe ai, “Antonio Gramsci”, tashmë bëjnë pjesë në historinë tonë të përbashkët.

---

<sup>84</sup> F. Guida, “Ricciotti Garibaldi...”, f. 136.

<sup>85</sup> M. Dogo, “Anno 1927: propaganda...”, f. 205-206.

<sup>86</sup> Zëdhënës i kësaj zgjedhjeje u bë atë kohë edhe gazetari e publicisti i njohur Indro Montanelli, i cili deklaronte më 1939, se “*Il destino dell’Albania è indissolubilmente legato al destino di Roma*”. Shih: Indro Montanelli, *Albania una e mille*, Torino: “Paravia”, 1939, f. 98.

*S u m m a r y*

## ITALIAN INFLUENCES IN THE ALBANIAN NATIONAL MOVEMENT

Starting from the mid 19<sup>th</sup> century the Albanian National Movement was strongly influenced by the Italian *Risorgimento*, especially in two of its main components: the affirmation of identity through the development of the language, national works and traditions; and in the preparation of a national revolution which apart from liberation from foreign rule would result in the creation of the nation state. Prominent leaders of the Albanian National Movement such as Pashko Vasa, Dervish Hima or Nikolle Ivanaj supported and tried to implement in Albania the revolutionary ideals of Giuseppe Mazzini. The influence of Mazzini's ideas and of the *Risorgimento*, were also important in the religious aspect. Considering that Albanians belonged to three different religions, this was a delicate issue the Albanian Awakening was faced with. The appeal of Pashko Vasa that "the faith of Albanians is Albanianism" goes along the same line with "the new religion" propagated by Giuseppe Mazzini who considered the traditional religions as symbols of the old regime (*ancient regime*).

An original and irreplaceable part in support of the National Movement was played by the Albanians of Italy. Above all, the great name and personality of Jeronim de Rada need to be highlighted. His activity goes along that of his patriots and contemporaries from Albania. However, we need to mention the fact that between the latter and De Rada there was a difference in the attitude towards the religious issue. While the Albanian patriots saw as the solution of this issue, secularity, de Rada thought that the solution was the return to the old faith, Christianity.

This approach came as a result of the substantial role that the orthodox religion played in the survival of the *arberesh* communities' identity in Italy. However, the attitude towards the religious issue is considered the only discord that existed between the Albanian patriots and the ones living in Italy. At the same time, overestimating the religious factor and the stereotypes deriving from it Francesco Crisp, a well-known Italian politician with Albanian ancestors, did not even consider the creation of an independent Albanian state, while he foresaw the establishment of a number of independent states in the Balkans, including a Macedonian state.